



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 516, datë 03.11.2021

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARES

Tiranë, më 03.11.2021

Ekstrakt

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE
PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit. Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e çështjes në 8 vendimet e analizuara, faktet parashtrohen gjithmonë në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit. Përshkrimi i rrethanave dhe fakteve të çështjes, në bazë të kategorisë së çështjes (*civile themeli, kërkesë civile*), është i qartë dhe

bëhet duke integruar edhe provat prej të cilave rezultojnë ato. Në vendimin nr. 134 (624), datë 11.02.2019, përshkrimi i fakteve konstatohet jo vetëm në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese, por edhe në vijim të provave të lejuara dhe të marra gjatë gjykimit, duke bërë edhe një analizë të provave në funksion të analizës juridike. Po kështu, tek pjesa e përshkrimit të fakteve gjyqtarja ndalet edhe në pretendimet e secilës palë ndërgjyqëse.¹ Në një rast, gjyqtarja nuk përshkruan faktet e çështjes, por përshkruan rrethanat procedurale, për shkak të natyrës së disponimit të gjykatës për pushimin e gjykimit, në kushtet kur paditësi hoqi dorë nga gjykimi i çështjes.²

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet e vëzhguara rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dhe herë pas here duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil, të Kodit Punës dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja ka referuar dhe cituar si pjesë të arsyetimit të vendimit, nenet 3, 6, 12, 18, 20, 28, 31 dhe 32 të K.Pr.Civile, lidhur me parimet themelore të procesit gjyqësor; nenet 211 dhe 212 të K.Pr.Civile, lidhur me ligjërimin apo rënien e masës së sigurimit (*vendimi nr.134 (624), datë 11.02.2019*). Gjyqtarja ka referuar dhe cituar nenet 158/a/2, 186 dhe 610 të K.Pr.Civile lidhur me vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake, ndalimin e marrjes së provave të reja pas nxjerrjes së urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore, si dhe padinë për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore (*vendimi nr. 1471 (6379), datë 16.12.2019*); nenin 510/a të K.Pr.Civile në lidhje me zgjidhjen e çështjes (*vendimi nr. 502 (4799), datë 30.09.2019*) dhe nenin 32 pika “b” të K.Pr.Civile, lidhur me legjitimitetin e palës paditëse për t’iu drejtuar gjykatës (*vendimi nr. 1149 (5094), datë 14.10.2019*).

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse.

- Në vendimin nr. 1207 (5349), datë 24.10.2019 (*padi marrëdhënie pune*), gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale (*nenet 141, 143, 144, 153, 155 të K.Punës*) lidhur me zgjidhjen e kontratës me afat të pacaktuar, procedurën e zgjidhjes, afatin e njoftimit, zgjidhjen e kontratës me efekt të menjëhershëm;
- Në vendimin nr. 1221 (5392), datë 28.10.2019 (*me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv*), gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale

¹ Vendimi nr. 134 (624), datë 11.02.2019;

² Vendimi nr. 1027 (4365), datë 16.09.2019;

njëkohësisht (*nenin 609 të K.Pr.Civile*) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, dhe po kështu ligjet e posaçme nr. 9073, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar më pas me ligjin nr.9997, datë 22.09.2008, si dhe ligjin nr. 43/2015;

- Në vendimin nr. 681 (2735), datë 27.05.2019, gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale (*nenet 312 dhe 313 të K.Civil*) lidhur me padinë e pushimit të cenimit të posedimit dhe padisë së rivendosjes në posedim;
- Në vendimin nr. 134 (624), datë 11.02.2019, gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale (*nenet 79, 92/a, 106, 111, 164, 659 të K.Civil, nenet 86 dhe 87 të ligjit nr. 6340, datë 26.06.1981, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprimit juridik*) lidhur me veprimin juridik, pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe konceptit të kontratës, (*nenin 168 të K.Civil*) lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë nëpërmjet parashkrimit fitues me titull.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e vëzhguara nuk rezulton të jetë evidentuar konflikt i normave procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe bën përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtarja në përputhje me rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes objekt shqyrtimi, referon, citon dhe interpreton norma të ligjit material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të arritura lidhur me zbatimin e tyre në zgjidhjen e çështjes.

Konkretisht, në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, në vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtarja, përveç citimit, ndalet edhe në interpretimin ligjor të tyre dhe më pas vijon me aplikimin mbi faktet konkrete, për të mbështetur konkluzionet e arritura lidhur me çështjen. Konkretisht, rezulton të jenë interpretuar dispozitat ligjore materiale si më poshtë:

- Gjyqtarja interpreton nenin 79 të K.Civil, në lidhje me vlefshmërinë e veprimit juridik duke listuar elementët e nevojshëm, të cilët duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe duke e analizuar secilin prej tyre në mënyrë të mëvetësishme. Interpretimi i kësaj

dispozite bëhet dhe në frymën e legjislacionit në fuqi, ku gjyqtarja argumenton se në rast të mungesës së njërit prej këtyre elementëve do të ndodhemi përpara rastit të pavlefshmërisë së veprimit juridik. Gjithashtu, gjyqtarja interpreton në mënyrë sistematike nenet 79, 92/a, 164, 659 dhe 663 të K.Civil dhe duke referuar në nenin 87 të K.Civil, (i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.01.1982) në funksion të argumentit se kontrata e shitblerjes është absolutisht e pavlefshme në kuptim të nenit 92/a të K.Civil, si një veprim juridik i kryer në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, konkretisht, me nenin 86 të K.Civil, në fuqi në kohën e lidhjes së martesës(*vendimi nr.134 (624), datë 11.02.2019*);

- Referuar interpretimit literal që i bën dispozitave materiale (*nenit 141, 143 dhe 144 të K.Punës*) dhe rrethanave të faktit, gjyqtarja konkudon se mënyra e zgjidhjes së kontratës së punës është ajo në mënyrë të menjëhershme, pa respektuar afatin e njoftimit, e për pasojë në lidhje me këtë mënyrë përfundimi, referenca ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes orientohet drejt normave materiale, neneve 153 dhe 155 të K.Punës, për të përcaktuar nëse shkaqet e zgjidhjes e justifikojnë këtë mënyrë përfundimi të marrëdhënies së punës me paditësin. Gjyqtarja interpreton dispozitën përkatëse (*nenin 153 të K.Punës*) duke analizuar në përputhje me faktet, kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative që të legjitimojnë punëdhënësin që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me punëmarrësin. Në lidhje me kërkimin tjetër për rikthimin në punë, gjyqtarja ndalet tek interpretimi literal i dispozitës (*nenit 155/3 të K.Punës*), duke argumentuar se ligji i jep të drejtën punëmarrësit që të përfitojë shpërblimin për zgjidhjen e kontratës së punës por nuk i jep të drejtën që të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës, përveç punëmarrësit të administratës publike. (*vendimi nr.1207(5349), datë 24.10.2019*);
- Interpreton në mënyrë sistematike dispozitat materiale (*nenet 312 dhe 313 të K.Civil*), lidhur me padinë e pushimit të cenimit në posedim dhe padinë për rivendosje në posedim (*vendimi nr.681 (2735), datë 27.05.2019*).

Në vendimin nr. 1149 (5094), datë 14.10.2019, nuk konstatohet që gjyqtarja të ketë bërë interpretim të ndonjë dispozite materiale apo procedurale, por konstatohet që gjyqtarja aplikon mbi faktet e çështjes dispozitën procedurale (*nenin 32 pika "b" të K.Pr.Civile*), lidhur me legjitimitetin aktiv të palës paditëse për t'iu drejtuar gjykatës, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e thjeshtë e objektit të padisë të trajtuar, konkretisht, qenies në marrëdhënie pune, me qëllim përfitimin e pensionit të pleqërisë.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, evidentohet se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve, rezulton se gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë: Parimi i zbatimit të ligjit të kohës; Parimi i procesit të rregullt ligjor, aspekte të të cilit rezultojnë nga konteksti i vendimeve të analizuar, në të cilat konstatohet se gjyqtarja i kushton rëndësi elementëve të tillë si: disponibiliteti i padisë nga ana e paditësit, barra e provës, prarimi i kontradiktorialitetit, etj.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, në shumicën e vendimeve të analizuara rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet:

- Në funksion të argumentit se gjykata nuk mund të veprojë në kundërshtim me rregullimet e bëra në nenet 6 dhe 28 të K.Pr.Civile dhe se gjatë shqyrtimit të një padie themeli gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e një veprimi juridik dhe zgjidh pasojat në lidhje me sa është kërkuar në objektin e padisë, referon në vendimin unifikues nr.5, datë 30.10.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- Në funksion të argumentit se në mbështetje të nenit 87 të K.Civil në të cilin përcaktohet se tjetërsimi i pasurive të përbashkëta të paluajtshme duhet të bëhet gjithmonë me pëlqimin e dy bashkëshortëve dhe dhënia e pëlqimit prej bashkëshortit në rastin e tjetërsimit të pasurive të përbashkëta të paluajtshme nuk kërkon domosdoshmërisht ndonjë formë të caktuar sikurse mund të jetë shkresa e thjeshtë apo akti noterial, gjyqtarja i referohet praktikës së konsoliduar të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimit nr.316, datë 29.05.2015.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet përfundimtare, në përgjithësi është e thjeshtë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në procesin civil, nuk evidentohet përdorimi i termave latinë, por parimet apo institutet përmenden në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalëve me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fytes apo denigrues.

Në tekstin e vendimeve gjyqësore konstatohet mospërdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip, pasi në asnjë prej tyre nuk evidentohet përdorimi i rregullt i shkronjave “ç” dhe “ë”.

Termet teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është e pashmangshme përdorimi i tyre.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit, por e njëjta rëndësi nuk evidentohet në drejtim të përdorimit të të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ç dhe ë).

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizmi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk ndjek një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor (*ashtu siç është parashtruar edhe nga gjyqtarja*), e për pasojë gjyqtari është i lirë në strukturimin e vendimit, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), apo cilado metodë tjetër, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen dhe konkluzionin e arritur.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se në vendimet gjyqësore që i nënshtrohen kësaj analize, gjyqtarja ndjek në hartimin e tyre një strukturë të

qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja në rastin konkret ka një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë (*edhe pse jo të listuara formalisht si rrethanat e faktit, legjislacioni i zbatueshëm apo vlerësimi dhe analiza juridike*), ku në mënyrë të detajuar gjyqtarja analizon: (i) rrethanat procedurale, në të cilën gjyqtarja rendit çështjet e kompetencës dhe juridiksionit (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iv) ligjin e zbatueshëm dhe (v) vlerësimin e gjykatës, ku gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionet e saj.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimit është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës, por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore apo parashikimi i titullit ekzekutiv të vendimit me marrjen formë të prerë të tij, sipas ndryshimeve në K.Pr.Civile. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi konstatohet e drejta e ankimit, e cila fillon pas marrjes dijeni në lidhje me arsyetimin e vendimit. Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, sipas pjesëve të vendimit, ku gjyqtarja zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionet e arritura.

Përveç titujve në nënndarjet e vendimit gjyqësor (*rrethanat e faktit, legjislacioni i zbatueshëm apo vlerësimi dhe analiza juridike*), të cilat nuk janë të vetmet mjete të mjaftueshme për organizimin e argumentimit logjik, janë edhe paragrafët ata që organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e mendimit, duke e ndarë atë në njësi më të thjeshta, secila me një fjali tematike kryesore. Në vendimet burim vlerësimi evidentohet në shumicën e rasteve ndërtimi i paragrafëve të gjatë, me disa fjali të nënrenditura, që jo gjithmonë pasqyrojnë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “Mbi mesataren” në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Përgjithësisht, në vendimet e analizuara, përdorimi i paragrafëve të gjatë me fjali të nënrenditura, zbeh ecurinë logjike të strukturimit të mendimit. Kjo metodologji e të shkruarit, jo vetëm vizualisht, por edhe në përmbajtje, jo gjithmonë i bën vendimet të lexueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtares për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të çështjes, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime, si më poshtë:

- Analizon mbi faktet e çështjes legjitimitetin aktiv të palës paditëse, duke argumentuar se paditësi, bazuar në nenet 143, 144, 145, 153 dhe 155 të Kodit të Punës, legjitimohet t’i drejtohet gjykatës me kërkesëpadi, sepse me anë të saj kërkon të dëmshpërblehet nga pala e paditur për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës. Gjithashtu, gjyqtarja analizon edhe legjitimitetin pasiv, duke argumentuar se në çështjen objekt gjykimi legjitimitet të rregullt pasiv ka vetëm një prej të paditurve, referuar subjektit që ka pasur cilësinë e punëdhënësit në kontratën e punës, si dhe subjektit që ka disponuar për largimin nga puna të paditësit (*vendimi nr. 1207 (5349), datë 24.10.2019*);
- Bazuar në nenin 609 të K.Pr.Civile, gjyqtarja analizon se fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike është tërësisht në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.05.2003, sa i përket formës së saj. Lidhur me pavlefshmërinë e titullit për shkak të elementëve që lidhen me përmbajtjen dhe themelin e titullit rezulton se OSHEE është person juridik që ka si objekt atë të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike bazuar në ligjin me nr.9072, datë 22.05.2003 dhe furnizimi kryhet në bazë të kontratave të lidhura rregullisht. Gjithashtu, gjyqtarja analizon mënyrën e faturimit të energjisë elektrike, referuar dispozitave të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, që është identifikuar nga gjykata si ligji i kohës kur ka lindur mosmarrëveshja, për faturat 2007-2015 dhe për faturat e tjera në ligjin me nr.43/2015, datë 30.04.2015, që ka shfuqizuar këtë ligj dhe që ka hyrë në fuqi më 12.06.2015, pasi është botuar në fletoren zyrtare në datë 28.05.2015 (*vendimi nr.1221 (5392), datë 28.10.2019*);
- Analizon konceptin juridik të *posedimit* duke e përkufizuar si një sundim efektiv mbi sendin, një marrëdhënie fakti të njeriut me sendin, por edhe një marrëdhënie juridike dhe të drejtë subjektive më vete; Analizon konceptin e *legjitimitetit aktiv dhe atij pasiv*,

duke argumentuar se ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet të bëhet vetëm nga ai që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar apo e shkelur dhe vetëm ndaj atij që me faktin ose veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesit; Analizon *padinë e pushimit të cenimit të posedimit si dhe padinë e rivendosjes në posedim*, duke bërë dhe dallimin midis tyre. Identifikon thelbin e konfliktit mes palëve ndërgjyqës edhe analizon kriteret ligjore të mjetit procedural me të cilin pala paditëse i është drejtuar gjykatës, duke konkluduar se nuk mundet që palët të përdorin mjete juridike që adresojnë te një marrëdhënie reale. Në vijim të këtij qëndrimi, gjyqtarja ka orientuar palën paditëse në lidhje me mjetin juridik që duhet t'i drejtohet gjykatës, nëpërmjet pavlefshmërisë së pjesshme të legalizimit, arsyetim që bazohet në faktin se paditësja në thelb pretendon se është pronare e sendit të paluajtshëm, objekt gjykimi dhe nuk ka vetëm të drejtën e posedimit, por edhe dy tagrat e tjera të pronësisë; Gjyqtarja orienton palën paditëse se të drejtat e saj mund të realizohen vetëm përmes kërkimit të cituar më sipër dhe më pas me padinë e pjesëtimit të sendit, duke paditur bashkëpronarin tjetër (*vendimi nr. 618 (2735), datë 27.05.2019*).

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse, në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi konkret.

Në tërësi, në të gjitha vendimet e gjyqtarës, analiza ligjore, si në lidhje me aspektet procedurale të zhvillimit të gjykimit, ashtu edhe në analizën ligjore të objektit në shqyrtim, zhvillohet e plotë, e thellë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili

tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 127 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, “*Civile pa palë kundërshtare*”, “*Familjare me palë kundërshtare*” dhe “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*”. Duke iu referuar objektit të çështjeve të pasqyruara në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se kërkesat janë: me objekt “*Kundërshtim i veprimeve përmbartimore*”, për të cilat neni 610 i K.Pr.Civile, parashikon një afat prej 20 ditësh për përfundimin e gjykimit; me objekt “*Kërkesë për ndihmë juridike dytësore*”, për të cilën parashikohet një afat prej 5 ditësh për përfundimin e tyre, sipas nenit 22 të ligjit nr.111/2017, “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”; me objekt “*Lëshimi i urdhrat të mbrojtjes*”, për të cilën parashikohet një afat prej 15 ditësh për përfundimin e tyre, sipas ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar dhe me objekt “*Zëvendësim i masës së sigurimit*”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 260 të K.Pr.Penale, duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës, me objekt “*Ankim nga vendimit të mosfillimit të procedimit penal*”, të cilat sipas nenit 291/3 të K.Pr.Penale duhet të shqyrtohen brenda një afati prej 30 ditësh, etj.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 128 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 8 (tetë)³ prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (8 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (128 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 6.25% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “0-10 %”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar në total 358 (treqind e pesëdhjetë e tetë) çështje (pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen në ligj

³ Në Tabelën nr. 1 çështja me numër rendor 14, 61, 166, në Tabelën nr. 2 çështjet me numër rendor 75, 180 dhe 181, në Tabelën nr. 3 çështjet me numër rendor 1, 2, 3 dhe 4, në Tabelën nr. 10 të gjitha çështjet nga numër rendor 1-118.

afate gjykimi), nga të cilat 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, 178 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë) çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, 9 (nëntë) çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, 3 (tre) çështje të kategorisë “Penale Krime” dhe 1 (një) çështje e kategorisë “Kërkesa në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD-së, përcakton këto standarde minimale kohore në gjykatën e shkallës së parë:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, rezulton se nga 358 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 115 prej tyre ose 32.12% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të tilla si: kompleksiteti i çështjes, marrja e provave nga institucionet që nuk janë palë në proces, njoftimi i palëve, i cili shpesh herë bëhet nëpërmjet afishimit me shpallje, që kërkon një minimum prej 20 ditësh, kërkesat e palëve që paraqiten gjatë gjykimin. Gjithashtu, edhe muaji gusht, muaji i pushimeve vjetore, ndikon në kohëzgjatjen e çështjes.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në raport me numrin total të çështjeve të gjykuara (*pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi*), si dhe kohës relativisht të shkurtër të tejkalimit të standardit minimal kohor në shumicën e çështjeve të analizuara sipas të dhënave statistikore, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi sesa ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara në tejkalim të standardit minimal kohor rezulton më e lartë se 30%. Rritja vetëm me një nivel vlerësimi është bërë duke mbajtur parasysh faktin se gjyqtarja për periudhën e vlerësimit nuk ka gjykuar më shumë se 50% të ngarkesës, konkretisht, gjyqtarja ka gjykuar 179 çështje me palë kundërshtare, ose 49% më shumë se treguesi sasior i përcaktuar në vendimin të KLD nr.261/2 të vitit 2010 (*gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare*).

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Mbi 20-30 %”, duke e pikëzuar me 3 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjyqimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht,

Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 184 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 50.3 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 242 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 94 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa në fazë e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 7 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve (3 nga 5 kategori), e cila sipas Metodologjisë, pikëzohet me 4 pikë. Duke marrë parasysh faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e çështjeve, për pasojë edhe në kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit analizohen në mënyrë të integruar, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, gjyqtarja ka paraqitur ecurinë procedurale të disa prej çështjeve civile të përgjithshme me palë kundërshtare, ku rezulton se shkaqet për zgjatjen e gjykimit tej afatit 6 mujor, kanë qenë të tilla si: kompleksiteti i çështjes, kryerja e veprimeve paraprake të domosdoshme për të mos cenuar procesin e rregullt ligjor, apo njoftimi i të paditurve me shpallje, etj., Po kështu, duhet të mbahet parasysh se koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për dy nga kategoritë e çështjeve, duke u tejkalluar ky afat me 4 ditë dhe 2 muaj për secilën kategori. Për këto arsye, në treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (486 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara (466 çështje) brenda vitit kalendarik, është 104.29 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “+99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 15.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 5.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 2.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit është 24.2 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Penale krime”, koha mesatare e arsytimit është 11 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, si dhe zëvendësim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 5.4 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë, i parashikuar nga nenet 249 dhe 260 e K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit me objekt verifikim kushtesh

dhe kriteresh, përjashtim gjyqtari, shuarje mase, koha mesatare e arsyetimit është 6.1 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë, i parashikuar nga neni 22/3, 248/2 dhe neni 261/3 i K.Pr.Penale.

- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt caktim mase sigurimi, vleftësim, lejim apo zgjatje e përgjimit, koha mesatare e arsyetimit është 2.3 ditë, pra më e gjatë se afati procedural prej 24 orësh, i parashikuar nga neni 244/1 dhe neni 222 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se:

- tejkalimi i afati procedural 20 ditor, për kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune” është me 4.2 ditë, edhe ky një tregues i ulët duke marrë parasysh edhe faktin që për disa çështje në afatin e arsyetimit përfshihen edhe dy ditët e pushimit javor;
- tejkalimi i afati procedural 5 ditor, për kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të hetimit paraprak-Zëvendësim/revokim mase sigurimi” është me 0.4 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë;
- tejkalimi i afati procedural 24 orë, për kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak-Lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi” është me 0.3 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar Raportit Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, mungojnë të dhëna lidhur me numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe në mungesë të kësaj të dhëne do u referohemi 5 (pesë)⁴nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”. Rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “Civile me palë kundërshtare” është 5.8 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet procedurën e kryerjes se njoftimeve, duke verifikuar se njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, si dhe janë dërguar pa vonesë. Nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët;
- Përgjithësisht, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: për të njoftuar palët për zëvendësimin procedural, për njoftimin dhe komunikimin e kundërpadisë palëve, për marrjen e informacionit të nevojshëm në dobi të hetimit gjyqësor nga të tretë, për marrjen e listës së ekspertëve nga Instituti i Policisë Shkencore, për njoftimin e ekspertit, për lënien kohë ekspertit për hartimin e aktit të ekspertimit apo kryerjen e detyrave shtesë, për t’u dhënë kohë palëve për të parashtruar diskutimin përfundimtar, të parashikuar në nenin 302 të K.Pr.Civile, për shpalljen e vendimit të arsyetuar etj.;
- Përgjithësisht, seancat gjyqësore janë zhvilluar me afate të shkurtra kohore, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga seanca paraardhëse. Vetëm në tre raste seanca është shtyrë në një kohë relativisht të gjatë, për shkak të pushimeve vjetore.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 5.8 seanca, por nga ana tjetër, konstatohet që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

⁴ Duke përjashtuar çështjen me nr. 502 (4799) vendimi, datë 30.09.2019, për shkak se i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjen menjëherë, ose deri në 4 (katër) ditë pas caktimit të çështjes me short. Në rastet kur janë konstatuar të meta të kërkesëpadisë, gjyqtarja ka marrë vendim për konstatimin e të metave të kërkesëpadisë, duke caktuar një afat për plotësimin e tyre. Me plotësimin e të metave brenda afatit të caktuar, në zbatim të nenit 158 të K.Pr.Civile, gjyqtarja ka nxjerrë urdhrin për njoftimin e palës së paditur dhe lëshimin e deklaratës së mbrojtjes. Ky akt procedural është i plotë, duke pasqyruar të gjitha urdhërimet dhe kërkesat procedurale për palën e paditur, si: deklaratën që duhet të lëshojë, dokumentet dhe provat që duhet të paraqesë dhe në sa kopje, afatin e paraqitjes së tyre, etj. Pas kryerjes së veprimeve paraprake të sanksionuara me ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile, në rastet kur ka qenë e nevojshme, gjyqtarja ka proceduar me nxjerrjen e vendimit për kalimin e çështjes në seancë përgatitore. Pas zhvillimit të seancës përgatitore, kur ka vlerësuar se çështja është e plotë, gjyqtarja ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Rezulton se në çështjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat përgatitore dhe ato gjyqësore janë mbajtur nëpërmjet sistemit të regjistrimit audio, si dhe janë pasqyruar në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit civil, sipas parashikimeve në K.Pr.Civile. Evidentohet se gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve, marrjen e vendimit në mungesë, shpalljen e trupit gjykues, deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për të parashtruar pretendimet e tyre dhe provat, lejimin dhe marrjen e provave në shqyrtim, debatin gjyqësor mbi të gjitha provat, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur me vonesa që shkojnë nga 17 minuta, deri në 1 orë e 59 minuta, por rezulton se në asnjë rast këto vonesa nuk janë bërë shkak për moszhvillimin e seancës gjyqësore.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se dosjet janë të renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik (sipas kategorive të akteve) dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda të njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme, duke përbajtur: kalim praktike gjyqësore, kërkesëpadinë dhe provat, vendimin për njoftimin e padisë palës së paditur dhe lëshimin e deklaratës së mbrojtjes, dëftesë komunikimi për vendimin e lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, deklarata e mbrojtës së palës së paditur, vendimin për njoftimin e deklaratës së mbrojtjes palës paditëse, vendimin për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, njoftimet, procesverbalin e seancës përgatitore, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin përfundimtar të gjykatës, si dhe CD-në e regjistrimit audio të seancave gjyqësore.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*padia, provat, deklaratat e mbrojtjes, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimet për njoftimin e padisë palës së paditur, vendimi për njoftimin e deklaratës së mbrojtjes, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave të pajtimit ose përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare*).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr.2068/1 Prot., datë 30.09.2020,⁵ ka informuar Këshillin se pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtarës {...} nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë ankesë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me shkresën nr. 3334 Prot., datë 21.04.2021, në bazë të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përcjellë për inspektim shkeljet e mundshme disiplinore, të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, gjyqtaren {...}. Kjo praktikë është regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2137 Prot., datë 22.04.2021.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.2137/6 Prot., datë 13.10.2021, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka vendosur arkivimin e rastit të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke arsyetuar se: *“Për sa më sipër nuk rezulton të ketë të dhëna të mjaftueshme apo prova të cilat të justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjstrates {...} lidhur me vendimin nr. 935 (4680), datë 09.11.2017, të dhënë prej saj ndaj të ndaluarave D.Sh. etj., dhe për këtë shkak rasti duhet arkivuar. Gjithashtu nuk rezultojnë të dhëna as për të referuar vendimmarrjen pranë KLGJ-së, për vlerësim etiko profesional të magjstrates”*.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara në vendimin e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

⁵ Protokolluar në Këshill me aktin nr. 4526/2, datë 01.10.2020.

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, ndaj gjyqtares {...} nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë ankesë.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.2373/1 Prot., datë 30.04.2021, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares dhe vlerësimi i kryetarit të gjykatës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2019–31.12.2019, janë paraqitur 2 (dy) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, të cilat rezultojnë të jenë rrëzuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 21 (njëzetë e një) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 13 (trembëdhjetë) kërkesa janë pranuar dhe 8 (tetë) kërkesa janë rrëzuar.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se rezulton se asnjë kërkesë për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi, nuk është pranuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces përdor në përgjithësi fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarëve me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarëve për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarëve në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019 ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues në 9

(nëntë) aktivitet trajnuese⁶ pranë Shkollës së Magjistraturës, në cilësinë e ekspertës/lehtësueses/pjesëmarrëses, konvertuar në numër ditësh 18.5 ditë.⁷

Gjyqtarja ka marrë pjesë në 9 aktivitete trajnuese të shtrira në 18.5 ditë trajnimi, brenda kufijve minimalë dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj, pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës civile dhe penale.

***Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime vlerësohet nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019), duke e pikëzuar me 20 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtarja {...}, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në 1 (një) aktivitet trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertës, aktivitet i zhvilluar në datën 5 korrik 2019. Po kështu, ka marrë pjesë në 3 (tre) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e lehtësueses, aktivitete të zhvilluar në datat 14-15 janar 2019, 21 qershor 2019 dhe 15 nëntor 2019. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e saj në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtar gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

⁶ Shkresa me nr. 753/1 Prot., datë 01.10.2020 e Shkollës së Magjistraturës.

⁷ Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: **1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim**”.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezultojnë se gjatë vitit 2019 gjyqtarja ka ribotuar me titullin “Standardet e gjykimit civil, administrativ dhe penal përmes vendimeve unifikues dhe njëses të Gjykatës së Lartë (2000-2019), në bashkëautorësi, me ISBN 978-9928-05-267-4. Për rrjedhojë, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike”, rezultojnë angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	95	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	98	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr. 96/2016, “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe të vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të përdorë të gjitha shkronjat e alfabetit shqip në vendimet e saj (përfshirë shkronjat “ç” dhe “ë”), si edhe të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitetet për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

Zëvendëskryetar
MAKSIM QOKU

Anëtar
MEDI BICI

Anëtar
ILIR TOSKA

Anëtare **Anëtare** **Anëtare** **Anëtare**
BRIKENA UKPERAJ FATMIRA LULI BRUNILDA KADI MARÇELA SHEHU

Anëtar/Reator
ERJON MUHARREMAJ

Anëtar
ALBAN TORO

Anëtar
DRITAN HALLUNAJ

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} KECERJA
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			95	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	12	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Mbi mesataren	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARËS				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				98	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	21-30%	3	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë

					<p>Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	+99%	10	<p>Tej standardit :</p> <p>Nën 81 %- 2 pikë</p> <p>Mbi 81-87 % - 4 pikë</p> <p>Mbi 87- 93 % - 6 pikë</p> <p>Mbi 93-99 % - 8 pikë</p> <p>+99% - 10 pikë</p>
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	<p>Koha mesatare:</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë</p> <p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>

B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares:

		3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit			E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				98	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë	1. Dosja personale e gjyqtarës	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera			
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarës 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarës	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			391		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARËS			Shkëlqyeshëm		